

STATUT I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“NIKHAT INDUSTRIES ALBANIA” sh.p.k

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar “NIKHAT INDUSTRIES ALBANIA” (e cila këtu e poshtë quhet “Shoqëria” është themeluar në bazë të Aktit të Themelimit nga ortaku i vetëm i Shoqërisë Znj Dallandyshe KOÇEKU, e dtl.05.06.1967 (E cila më poshtë do të quhet ORTAKE E VETME E SHOQERISE).

Kjo SHOQERI në përputhje me legjislacionin shqiptar e veçanërisht me Ligjin me Nr. 9901, datë 14.04.2008 ‘Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare’ krijohet nga ORTAKJA E VETME E KESAJ SHOQERIE për të ushtruar veprimtari të ndryshme sipas parashikimeve të bëra në Aktin e Themelimit apo nga ky Statut.

NENI 1

EMERTIMI

SHOQERIA emërtohet “NIKHAT INDUSTRIES ALBANIA”

SHOQERIA është një person juridik I së drejtës shqiptare dhe zhvillon veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar si dhe dispozitat e Aktit të Themelimit dhe të këtij STATUTI.

SHOQERIA do të quhet person juridik dhe do të veprojë si e tillë duke filluar nga dita e regjistrimit të saj, ndërsa veprimtaria ekonomike fillon me regjistrimin e saj në organet tatimore. Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar është një shoqëri tregtare, e themeluar nga persona fizikë ose juridikë, të cilët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Kontributet e ortakevë përbëjnë kapitalin e regjistruar të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar. Shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara nuk mund të ofrojnë kuotat e tyre si mjete investimi për publikun e gjerë.

Kapitali minimal:

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar ka një kapital prej 100 000(njeqindmije) lekë I cili është I përbërë nga 1(një) kuotë.të barabartë me 100% për Ortakun e Shoqërisë. Kuotat e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar zotërohen nga një person që është edhe Ortakja e vetme e Shoqërisë.

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) Kontributit në kapitalin e shoqërisë
- b) Shitblerjes
- c) Trashëgimisë
- d) Dhurimit



- e) Çdo mënyrë tjetër të parashikuar në ligj. Nëse shoqëria zotërohet nga një ortak, të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithëshme ushtrohen nga ortaku I vetëm. Të gjitha vendimet e marra nga ortaku I vetëm rregjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen apo fshihen. Duhet rregjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:
- a) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë.
 - b) Shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve
 - c) Investime
 - d) Vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundërshtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se I treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte patur dijeni për të.

NENI 2

OBJEKTI VEPRIMTARISE I SHOQERISE

Objekti I veprimtarisë së SHOQERISE është:

Import-Eksport Shërbime Online në Fushën e Inovacionit dhe Teknologjisë Bashkore (Brenda dhe jashtë territorit të Republikës Së Shqipërisë). Shërbime Inovative suporti për aplikacione të ndryshme si: Software Development, Mobile IT Support Servis, Web Development and Website Creating, Logo design, Data analysis, Sales and marketing consultant, Business coaching, Link building services, Online stock assistant etj, ndërmjetësim shërbimi midis palëve në tregun e lirë, Agjensi marketingu, shërbimi e ndërmjetësimi si dhe komisione të ndryshme për shërbimet e ofruara ndaj klientëve. Përmirësimet dhe përditësimet e të gjitha llojeve të shërbimeve në fushën e Inovacionit dhe teknologjisë bashkohore mbështetur në eksperiencat dhe teknologjitë e fundit botërore, rrjete telekomunikacioni etj.

NENI 3

SELIA E SHOQERISE

Selia e shoqërisë do të jetë në Adresën Rr. Memo Meto, Nd.nr 24, Hyrja nr 1, Ap nr 17, Njësia Administrative Nr 8, 1017, Tiranë.

NENI 4

KOHEZGJATJA E SHOQERISE

Kohëzgjatja e shoqërisë është përcaktuar pa afat.

NENI 5

KAPITALI THEMELTAR



Kapitali themeltar I SHOQERISE është 100 000 (Njëqindmijë lek).

Pjesmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

Ortaku Themelues Znj. Dallandyshe KOÇEKU , është zotërues I një kuote të barabartë me 100.000 lek(njëqindmijë lekë) që përbën 100% te kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kapitali themeltar mund edhe të zmadhohet dhe me kontribute në natyrë. Zmadhimi dhe zvogëlimi I kapitalit themeltar të SHOQERISE bëhet me vendim të ORTAKUT TE SHOQERISE.

NENI 6 VEPRIMET FINANCIARE

Veprimet financiare të SHOQËRISË pasqyrohen në llogaritë (kontabilitetin) e saj duke aplikuar kriteret e dispozita mbi kontabilitetin e Shoqërive Tregtare të parashikuar në legjislacionin shqiptar.

Zmadhimi dhe zvogëlimi I kapitalit themeltar bëhet me vendim të ORTAKUT TË SHOQËRISË.

Fondi me të holla që vjen nga shlyerja e pjesëve të kapitalit themeltar për llogari të shoqërisë do të jetë në Bankën e Kursimeve, Banka Raiffeisen sh.a.

NENI 7 BLERJET E SHOQERISE

SHOQËRIA disponon dhe gëzon pasurinë e saj në përputhje me qëllimin dhe objektin e themelimit të saj. SHOQËRIA ka të drejtën e blerjes dhe administrimit të pasurisë të cdo lloj e natyre si edhe të japë garanci si mjet sigurimi mbi pasuritë e saj për përmbushjen e detyrimeve që merr përsipër kundrejt të tretëve.

NENI 8 BILANCI DHE FONDET E SHOQERISE

SHOQERIA për ushtrimin e aktivitetit të saj krijon fondet e saj. Përbërja, madhësia e tyre, burimet e krijimit, përdorimi e rregullimi I çdo fondi të veçantë vendosen nga ORTAKU I saj, duke respektuar dispozitat përkatëse në fuqi.

SHOQERIA disponon mjetet e saj financiare. Te gjitha detyrimet e mundshme gjatë veprimtarisë së SHOQERISE do të mbulohen nga fondet përkatëse apo fondet rezervë, ose edhe me zmadhimin e kapitalit themeltar. Të gjitha pasuritë e SHOQERISE pasqyrohen në bilancin e saj me vlere të shprehur në monedhë shqiptare.



Bilanci dhe llogaritë e SHOQERISE përpilohen dhe mbahen nga Administratori.

Viti financiar (ushtrimatori) fillon me datën 1 Janar dhe mbaron me datën 31 Dhjetor të çdo viti kalendarik.

Përfundimisht viti I parë financiar fillon datën e regjistrimit të shoqërisë pranë organeve tatimore dhe përfundon me 31 Dhjetor 2021.

NENI 9

ADMINISTRIMI I Shoqërisë

Shoqëria do të administrohet nga zoti Klevis SKENDAJ, në përputhje me Statutin dhe dispozitat respektive të Ligjit 9901" Për Shoqëritë Tregtare dhe tregëtarët". Administratori është i zgjedhur për 5 vjet me të drejtë rizgjedhje.

Rregullat për funksionimin dhe drejtimin e shoqërisë janë përcaktuar në Statutin e Shoqërisë private që shoqëron këtë Akt Themelimi.

Të gjitha mosmarrëveshjet me organet shtetërore, personat juridikë e fizikë, vendas e të huaj, do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

NENI 10

Administrator I Shoqërisë ushtron të gjitha kompetencat, të drejtat dhe detyrimet për organizimin dhe drejtimin e SHOQERISE të parashikuara nga ky STATUT, Akti I Themelimit si dhe nga legjisllacioni tregtar shqiptar.

NENI 11

TE DREJTAT DHE DETYRIMET E ADMINISTRATORIT

- Kryen të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme.
- Përfaqëson shoqërinë tregtare
- Kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe tË librave kontabël të shoqërisë.
- Përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, I paraqesin këto dokumenta përpara asamblesë së përgjithëshme për miratim. Krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë.
- Kryen regjistrimet dhe dërgon të dhëna të detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.



- Raporton përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare.
- Kryen detyra të tjera të përcaktuara në ligj e statut.
Në rastet e parashikuara nga pikat 3 e 5 te nenit 82 të këtij ligji, administrator është I detyruar të thërrasë asamblenë e përgjithshme. Asambleja e përgjithshme në çdo kohë mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë. Statusi apo marrëveshjet e tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë. Paditë, që mund të lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

NENI 12 MARREDHENIET E PUNES

Marrëdhëniet e punës ndërmjet SHOQERISE, filialeve e agjensive të saj (nëse krijohen të tilla) dhe punonjësve të saj rregullohen me Kontratën e Punës. Për çështjet paparashikuara në kontratën e punës zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar.

NENI 13 NDRYSHIMET NE STATUT

Ndryshimet në STATUT mund të bëhen me vendim të ORTAKUT TE SHOQERISE dhe sipas dispozitave ligjore të parashikuara në ligjin nr. 9901 dt. 14.04.2008 ‘‘Për tregtarët dhe shoqërit tregtare’.

NENI 14 SHNDERRIMI I SHOQERISE

SHOQERIA mund të shndërrohet në një shoqëri anonime me vendim të Ortakut dhe në përputhje me Legjislacionin Tregtar Shqiptar. Shndërrimi I SHOQERISE në një shoqëri tjetër do të konsiderohet i vlefshëm vetëm duke respektuar dispozitat ligjore të parashikuara nga Ligji Nr.9901 dt. 14.04.2008 ‘ Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare’



NENI 15
PRISHJA E SHOQERISE

SHOQERIA prishet në rastet kur:

- Mbaron afati I përcaktuar në këtë Akt Themelimi;
- Nuk mund të realizohet objekti I Shoqërisë sipas Aktit të Themelimit dhe Statutit;
- Një vendim të tillë I marrë nga Ortaku I Shoqërisë;
- Me hapjen e procedurave të falimentimit;
- Nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi I veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 'Për Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit';
- Me vendim të gjykatës
- Për arsye të tjera, të parashikuara në statut.

NENI 16
LIKUJDIMI I SHOQERISE

Likujdimi I Shoqërisë do të bëhet sipas dispozitave të legjislacionit shqiptar në fuqi në çastin e likujdimit. Ortaku vendos rregullat për procedurë e likujdimit si dhe për personat që do ti aplikojnë ato. Në rast prishje të Shoqërisë pasuria e mundshme që mbetet pas shlyerjes së të gjitha detyrimeve të Shoqërisë I mbetet Ortakut.

NENI 17
DISPOZITE E FUNDIT

Ky STATUT u njoh dhe u nënshkrua nga Ortaku I shoqërisë në Tiranë më Datë 22/02/2021

ORTAKU I SHOQERISE 'NIKHAT INDUSTRIES ALBANIA sh.p.k

Znj. Dallandyshe KOÇEKU

Dallandyshe Koçeku

[Signature]